

# KOSOVARJA

## HISTORY MAKERS

**"FC BALLKANI"**  
NJË HISTORI  
SUKSESI  
E SHKRUAR ME  
SHKRONJA TË  
ARTA

2023 - 2024







SHERWOOD  
Resorts and Hotels



GREENWOOD  
Resorts and Hotels

*feel the legend*



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD  
Gölkaya Resort



SHERWOOD  
Gölkaya Lara



SHERWOOD  
Dünya Resort



SHERWOOD  
Pamukaltı



3UE  
Türkiye  
Seyahat



GREENWOOD  
Kızıllı Resort




GREENWOOD  
Kızıllı Resort

[sherwoodhotels.com.tr](http://sherwoodhotels.com.tr) | [greenwoodhotels.com.tr](http://greenwoodhotels.com.tr)

+90 444 86 07

Ku janë...



# Hasan Salaj, *spiker i rrallë*

Njihej në të gjithë Kosovën dhe jo vetëm. Atë e bëri të njohur gjuha e folur me theks të përkryer shqip në Radio dhe Televizionin e Prishtinës. Profesionin e spikerit në këtë institucion mediatik e ushtroi me dashuri të madhe për 25 vjet.

U lind më 1944 në Katërkollë të Ulqinit.

Aty mbaroi shkollën fillore, Shkollën Normale në Gjakovë, ndërkaq studimet në Fakultetin Filozofik të Prishtinës-Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Ka qenë viti 1965 kur ai do të ngjitej në shkallët e Radio Prishtinës.

Në atë kohë ishte shqiptari i parë nga komuna e Ulqinit që ushtroi zanatin e folësit në mediet e Kosovës.

“Me profesionin e spikerit në Radio dhe Televizionin e Prishtinës fillova të merrem në vitin 1965. Fillimi ka qenë i rastësishëm. Me rekomandimin e profesorit të nderuar Anton Çettës, ia dola që në mesin e një numri të konsiderueshëm kandidatësh për spikerë, komisioni më zgjodhi mua.

Por, para se të lexoja drejtpërdrejt në mikrofon, së bashku me profesorin e çmuar Anton Çettën pata ushtuar me të leximin gati për nja tre muaj rresht nga dy apo tri orë në ditë”, thotë ai.

Më 1969 në televizionin e Beogradit për herë të parë hapet studio në gjuhën shqipe, ku emetoheshin tri herë në javë lajmet dhe një emision tematik me emrin “Shkëndija”.

Pas një periudhe të caktuar kohore, më 1974 Kosova themelon televizionin e vet të pavarur, që ishte një ngjarje jo vetëm kulturore, por edhe historike.

Natyrisht, puna kryesore e Hasan Salajt në këtë institucion ishte leximi i lajmeve dhe drejtimi i ditarit kryesor, bashkë me kolegë të tjerë.

Fakti se gati 25 vjet është shoqëruar me mikrofon, e nëse këtyre vjetëve u shtohen edhe pesë të tjera në televizionin e Komunitetit shqiptar të Nju-Jorkut “TV Victoria”, flet se mikrofoni ka qenë dhe mbetet pjesë e jetës së Hasan Salajt.

Tash është në pension. Jeton në Amerikë.

## “Humbi” Buqja!

“Ku mbet Buqja e serialit “Familja moderne”?

Xhejlane Godanci, sidomos me rolin në serialin e përmendur, arriti jo vetëm të bëhet e njohur, por edhe shumë e pëlqyer për audiencën e gjerë.

Emri i saj nga turqishtja do thotë drenushë.

Por, drenushën shikuesit e njohin më shumë si Buqe, meqë ka luajtur edhe në seriale të tjera të vendit.

Xhejlanja gjithmonë ka theksuar se nuk përngjanë fare me Buqen e serialeve.

Në realitet është krejt tjetër: e qetë, e hareshme, modeste...





Edhe kjo pamje është pjesë e Prishtinës...

# Vetëm inkasanti i rrymës *na troket në derë!*

*Vetëm pak minuta larg qendrës së Prishtinës, varfëria ka mbuluar një lagje të tërë. Shumë prej familjeve që banojnë në afërsi të parkut të qytetit përballen me varfëri të skajshme.*

Në njërin prej shtëpive në lagjen afër parkut të qytetit jeton një familje me tre fëmijë.

E zonja e shtëpisë, me lakmi i shikon gratë e qytetit se si dalin e shëtisin nëpër park, e ajo rropatet me hallet e veta se si do i ushqejë fëmijët e saj. "Në karriget që i kanë vendosur në park ulem çdo ditë, mendohe... Edhe unë kam qejf e nevojë me dal e me shëtit me fëmijët e mi, si këto gra që po shëtisin tash, para syve tanë, por unë kam gajle më të mëdha...

Kohën e kaloj duke menduar se çka kam me u shtrua fëmijëve në sofër çdo ditë!", thotë ajo, teksa me cepin e shamisë fshinë

lotin që i rrjedhë rrëke fytyrës.

Por, ndonëse ka vite që përballen me varfëri të skajshme, nuk i ka humbur shpresat kurrë se do të kenë një jetë më të mirë...

Ajo, por edhe burri i saj, janë të papunë. E, se kah marrin për t'i ushqyer fëmijët, vetëm një Zot e di!

"Në këtë lagje banoj. I kemi kushtet e rënda. Në këtë kasollë jetoj me fëmijë e burrë. Jemi të papunë të dy, e mezi po arrijmë me jetua", thotë me zë të shterur nëna e 3 fëmijëve.

"Shtëpia është jo vetëm e vjetër, por edhe e shkatërruar. Na kanë vizituar disa njerëz humanitarë, e ndoshta në pranverë na

ndihmojnë, por jo edhe politikanët, të cilët tash kërkojnë t'i votojmë.

Por, unë s'e kam hallin te votat, por te buka e fëmijëve!", thotë ajo, teksa shpreson në një ditë do të bëhet mirë...

## A ËSHTË KJO E VETMJA FAMILJE?

Fatkeqësisht, kjo nuk është e vetmja familje në Prishtinë që jeton në kushte të vështira, por ka edhe mijëra familje të tjera që jetojnë në kushte, ndoshta, edhe më të vështira e më të këqija se kjo.

Zoti i ndihmoftë!

**Diturie Haxhaj**



NJË HAP  
MË AFËR  
**BANESËS SË  
ËNDRRAVE!**

**CIMA GRAND COMPLEX**  
PRISHTINA E RE

+383 49 509 090  
[www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)

# A është edhe populli si liderët?

*Është vështirë të lindet njeriu që e kishte kërkuar Migjeni në poezitë e tij, në krijimtarinë e tij, duke arsyetuar ndryshimin me lindjen e atij njeriu: “Të lindet një njeri!”.*  
*Por, po bëhet një shekull që po kërkohet ai njeri...*

A do të ishte ai një Skënderbe apo një tjetër njeri, pak ka rëndësi, por rëndësia qëndron në faktin se ai duhet lindur që t'i orientojë shqiptarët në rrugën e duhur kombëtare. Por, deri më tani nuk është lindur! Një i tillë, përafërsisht siç e lupte Migjeni, ishte Ibrahim Rugova, pas të cilit, gjatë një dekade të plotë u rreshtua populli i Kosovës dhe u betua në të... Ditë më parë, në një ndejë, rastisa të pija një gotë verë me një fqinj timin, i cili dikur ka punuar në një post komunal. Dhe, si pensionist, tash ka kohë të lirë për debate spontane... Ma mori për të madhe kur i thashë se

buxhetin e Kosovës po e keqpërdorin qeveritë njëra pas tjetrës, kryesisht me dhënien e tenderëve, madje edhe një burimor! Por, nuk pajtohej se buxheti keqpërdorej! Nuk pajtohej se Kosovës bisedimet në Bruksel i kanë sjellë dështime, ndërsa Serbisë avancim për në Evropë. Nuk pajtohej se qeveritë njëra pas tjetrës e kanë sjellë Kosovën buzë falimentimit ekonomik... Pse nuk pajtohej? Sepse, njerëzit si ai, e që nuk janë absolutisht në ngjarje me rrethanat politiko-ekonomike në Kosovë, akoma vlerësojnë me ato kute që kishin

matur dikur në komunizëm, e që e kishin matur copën e prerë të basmës se duhet t'u bie tamam të gjithëve që kanë nevojë për veshje! Dhe, i ngarkuar me zhgënjim, i thashë vetes: Kush do ta lindë atë njeri në këtë masë?! Përgjigja më vjen nga brendia e shpirtit: Me siguri, tash jo se jo, por brezat e ardhshëm do ta lindin njeriun që e ka kërkuar Migjeni, që do t'i drejtonte shqiptarët në rrugën e civilizimit botëror dhe të respektimit të ligjit dhe shtetit. Kështu, njeriu migjenian do të duhej t'i trajtonte njëjtë të gjithë shqiptarët, pavarësisht orientimit të tyre politik.

**Burim Bajrami**





# KAH PO SHKOJMË?



*Ky shkrim mund të mos nënshkruhet me emrin tim. Janë fjalë të nxjerra nga shkrimet, mendimet e të tjerëve. I nxora me qëllim fjalë të thëna edhe para njëqind vjetësh, por që vlejné edhe sot të përmenden, të rikujtohen...*

Kush ishim, ku jemi, kah po shkojmë?

Pyetje këto që i dëgjon jo rrallë në muhabetet tona, në dialogët me njëri-tjetrin.

Ne i kemi shkruar me gjakun tonë mjaft faqe të historisë jo vetëm të Evropës...

Vlen të përmendim faktin se shqiptarët i kanë dhënë Turqisë hiç më pak se 35 kryeministra në katër shekuj e gjysmë dhe një numër të madh komandantësh ushtrie e diplomatësh.

Një gjë e tillë e shqiptarëve në shtetet e huaja ka qenë gati përherë dhe vazhdon të jetë edhe sot. Sa shqiptari është nëpër botë që kontribuon në sfera të ndryshme të jetës?!

Nuk janë të paktë ata shqiptarë që i njeh bota...

Për shqiptarët janë shkruar faqe e faqe, jo vetëm nga studiuesit e ndryshëm ndërkombëtarë, por edhe nga të shumtë gjeneralë e politikanë të shteteve të ndryshme të botës.

Lord Bajroni shkruante: "Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë një peizazh më të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre..." Shqiptarët janë

banorë më të vjetër të Gadishullit Ballkanik, të racës ariane, duke nxjerr këtë fjalë nga dy rrënjët e fjalëve shqipe: ar dhe anë, d. m. th., njerëz të arit të pastër", shkruan Edvin Pears.

Për karakterin e tiparet tona ishim të veçantë dhe na lakmonte shumëkush. U bëmë ballë të gjitha sulmeve shekullore, nga sulmet e romakëve, nga Perandoria Otomane, sulmet e sllavëve, të cilat na tkurrën e na lanë të shpërndarë në pesë copë jashtë atdheut. Janë munduar të na e zhdukun prej faqes së dheut edhe emrin shqiptar.

Hiq më pak se 600 vjet okupimesh dhe s'arritën të na zhdukun, mbetëm këta që jemi sot...

Por, e keqja se edhe sot vlen thënia e të madhit Konica se armiku i shqiptarit është shqiptari. Por, në paqe e në liri, përditë po zbehet nga një e mirë shqiptare, e karakterit, e tipareve, e virtyteve, madje edhe i kostumeve të identitetit tonë.

Dhe, vërtet, siç pyesin e thonë jo pak vetë: Kush ishim, ku jemi, kah po shkojmë?

**Gani Dili**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

**Dizajni:**

Labinot Bërbotovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

**Tel:** 038 51 75 75

**Email:** [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

**Email:** [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

# Po të ishte gjallë Enver Hoxha...

*Të shtunën mbrëma, në një ndejë të zakonshme, duke u bërë pjesë e ndjenjës më të hidhur prindërore të një emisioni “Njerëz të humbur”, njëri tha: “Ah, t’ishte Enver Hoxha gjallë!”. Pse?*



Aty ku lëndohet ndjenja prindërore,  
thahet zemra!  
Aty ku preket ndjenja prindërore, këputet  
shpirti!  
Andaj, aty ku ndodhin këto lëndime  
prindërore, duhej vënë litari i varjes!  
Nëse dikush që lëndohet do e bënte ligjin,  
ai do e rikthente në pushtet Enverin!  
Pse?  
Do i ndalte vjedhjet;  
Do i ndalte maltretimet dhe vrasjet ndaj  
vajzave e grave;  
Do i ndalte rrahjet;  
Do i ndalte therrjet me thika;  
Do i ndalte vrasjet në përgjithësi.  
Dhe, çka jo tjetër?!  
Thënë ndryshe, bota po rikthehet te  
reziku i mungesës së ligjit...  
Konkretisht, na humbin fëmijët dhe  
trafikantët arrijnë t’i dërgojnë në fund të  
botës!  
E, kur është fjala te fëmijët, ne, shqiptarët,  
dallojmë nga njerëzit e botës.  
Kështu, teksa shikoj një dokumentar

kanunor të pajtimit të gjaqeve me moti  
nga Shqipëria e zonave të largëta malore,  
një familje, mbyllur në kullë, siguron  
bukën e gojës nëpërmjet fuqisë së grave.  
Burrat në shtëpi jetojnë rreth pesëdhjetë  
vjet të ngjuar!  
Në përpjekjet për pajtimin e tyre kishin  
marrë pjesë shumë burra, por lutjet nuk  
kishin kryer punë...  
Dhe, pas pesë dekadash të ngulitur, burri  
i shtëpisë që kishte gjak borxh, del nga  
kulla me djep në krahë e foshnje në të  
dhe e çon te dera e familjes që të merrte  
hakun.  
E lë djepin para dera dhe kthehet për në  
shtëpi.  
I zoti i kullës e shikon hasmin nëpërmjet  
frenxhive të shtëpisë.  
Ishte dimër. Veriu fishkëllente.  
Fëmija në djep, i mbuluar me batanije,  
qante.  
Zëri i tij dëgjohej në kullën e hasmit...  
Anëtarët e familjes dëgjonin zërin e fëmijës  
teksta qante, por askush s’kishte guxim

t’i thoshte plakut të shtëpisë a ta marrin  
brenda...

## PSE VRASËSI E LA FËMIJËN TE DERA E HASMIT?

Lënia e fëmijës në djep te dera e hasmit,  
sipas kanunit, ka kuptimin se nëse i zoti i  
shtëpisë e merr djepin me fëmijën e lënë  
të dera, e ka falur gjakun.

Andaj, nisur nga kanuni, plaku del te dera  
e oborrit dhe e merr djepin me fëmijën e  
hasmit dhe e afron pranë oxhakut në odë  
për ta ngrohur...

Ndërkohë, disa burra ia mësojnë shtëpisë  
ku ishte lënë foshnja në djep.

I pari, duarlidhur, prinë vrasësi, ai që ka  
vlarë palën tjetër. Sipas kanunit, litarin e  
prenë me thikë pala e dëmtuar, nën reflek-  
sionin simbolik se e falë gjakun...

Andaj, atë që nuk kishin mundur ta bënin  
burrat e dheut në pajtimin e gjakut, e  
bënte fëmija që nuk fliste ende!

## KANUNI NDERON FËMIJËT DHE GRATË

Pra, kjo është vlera shqiptare nga kanuni, e  
cila respekton fëmijët dhe gratë.

Nëse burri do marrë gjakun, e nëse ai që  
do të vritej ishte me grua a fëmijë, nuk e  
vriste në prani të gruas a fëmijës!

E linte për një herë tjetër...

Pse?

Sepse, po ta vriste burrin në prani të gruas  
a fëmijës, si gruaja ashtu edhe fëmija do  
të traumatizoheshin dhe tërë jetën do e  
mbanin mbi supë atë barrë...

**Selim Rama**



# “FC Ballkani” - një histori sukcesi e shkruar me shkronja të arta



“FC Ballkani” është themeluar në vitin 1947. Vite me radhë ka mbledhur rreth vetes futbollistë nga komuna e Suharekës, por që fanellën e tij e kanë djersitur edhe lojtarë nga regjione të tjera. Andaj, në krijimin e futbollit të pavarur, “FC Ballkani” luajti rol vendimtar...





Në vitin 1995 "FC Ballkani" siguroi pjesë-marrjen në Ligën Unike, të formuar atë vit ose superliga e sotme. Deri në atë kohë, nga viti 1991 garat ishin zhvilluar në katër grupe.

Klubi arriti të organizojë edhe kategoritë e reja, kur me kadetë u shpallën edhe kampion të Republikës së Kosovës më 1994. "FC Ballkani" në vitin 2022 është shpallur kampion, për të vazhduar edhe dy vjet me radhë - më 2023 dhe 2024, por sërish është në rrugën për t'u bërë kampion për herë të katërt radhazi.

## NGRITJET E "FC BALLKANIT"

Sidoqoftë, paslufta "FC Ballkanin" e gjeti të dërmuar.

Pozitiv ishte rikthimi në stadiumin e qytetit, por u paraqit, kryesisht, me lojtarë juniorë, duke rënë nga kategoria e parë.

Klubi më pas kishte luajtur edhe në kategorinë e tretë, derisa në vitin 2010 u rikthye në Superligë.

Pas një viti, me një ndeshje të barazhit, pësoi duke kaluar sërish në kategorinë e dytë!

Në 70-vjetorin e tij "FC Ballkani" pa sërish dritë. Në krye të klubit erdhi Kompania Ndërtimore "Cima construcion", e cila për pak kohë e shndërroi ekipin në konkurrenues për titull.

Presidenti Arsim Kabashi, me të ardhur në krye të klubit, krijoi bordin drejtues dhe atë menaxhues profesional.

Pas rikthimit në elitë në vitin 2017/18, në skuadër erdhën lojtarë dhe trajnerë të dëshmuar në futbollin e Kosovës dhe atë shqiptar.

Viti 2022 për "FC Ballkanin" dhe futbollin suharekas do të shkruhet në histori, meqë për herë të parë është shpallur Kampion i Kosovës.

"FC Ballkani" për herë të parë në muajin korrik të vitit 2022 është paraqitur në arenën ndërkombëtare.

## FANELLA E "FC BALLKANI"

"FC Ballkani" nga viti 1947, kryesisht, është paraqitur me fanellën e bardhë, mirëpo prej vitit 1974 fanella dhe logo e klubit marrin ngjyrat zyrtare - portokall e zi, ku dominon ngjyra e portokalltë.

Me këtë fanellë skuadra paraqitet, kryesisht, në ndeshjet të cilat i zhvillon në shtëpi.

Fanella e dytë e "FC Ballkanit" është me ngjyrë të bardhë, e cila simbolizon fanellën e fillimit të themelimit të klubit, ku qëllimi i themelimit ishte argëtimi dhe paqja.

E, fanella e tretë e klubit në edicionin 2022/23 është me ngjyrën e zezë.





## TIFOZËT ULTRAS “XHEBRILAT” - ENERGJIA E “FC BALLKANIT”

Aset i madh i klubit në vazhdimësi kanë qenë edhe tifozët, të cilët nga viti 1992 njihen të emëruar si “Xhebraila”. Ultrasit, si në ndeshjet në shtëpi, po ashtu, edhe në udhëtim, vazhdimisht ishin përkrahë skuadrës.

Arsim Kabashi e shndërroi “FC Ballkanin” në një model të futbollit shqiptar. Janë më shumë se 7 vjet që “FC Ballkani” i ka dhënë dimension tjetër futbollit të Kosovës.

Që nga rikthimi në Superligë, ka filluar epoka e ndërtimit të një skuadre, e cila nuk do të mjaftohej me asnjë të arritur. Këmbëngulësia për të qenë gjithmonë konkurrues, idetë dhe planet konkrete të udhëheqësisë së klubit, në krye me presidentin Arsim Kabashi, e kanë shndërruar “FC Ballkanin” në një model reprezentimi të futbollit shqiptar, sidomos në arenën ndërkombëtare.

Falë kësaj strategjie, sot klubet shqiptare nuk mjaftohen më me pjesëmarrje në kualifikimet evropiane, por ambiciet dhe objektivat janë gjithmonë më të mëdha dhe reale.

Ky lloj revolucioni i futbollit të Kosovës nisi dhe po vazhdon me “FC Ballkanin”, sigurisht duke u hapur rrugë të gjitha skuadrave tona të shtetit.

## “FC BALLKANI” E NDRYSHOI RRËN- JËSISHT HISTORINË NDËRKOMBËTARE TË FUTBOLLIT TË KOSOVËS

Ndërkohë, mësojmë se edhe konkurrenca e madhe kualitative brenda grupit është element shumë i rëndësishëm për t’u motivuar, që, duke dhënë 100% nga vetja, të mundë ta bindësh trajnerin për minuta në ndeshje. Kurse, tifozët, pa dyshim, janë ajka e çdo motivi për lojtarët.

“FC Ballkani” në tre vjetët e fundit ka qenë në nivel jashtëzakonisht të lartë, paraqitet fantastike ndaj disa prej emrave të mëdhenj të futbollit ndërkombëtar, gjithsesi janë periudha që do t’i ruajë historia.

Megjithatë, kjo mbetet si epokë e artë e deritanishme, meqë oreksi i klubit është shtuar dhe në këtë rast nuk mjaftohen me kaq, duke deklaruar se ky është vetëm fillimi.

**Nderim Neziri**



# Si e njoha Rajmonda Bulkun?



Rajmonda Bulku në vitet 90

*Më 1 shtator të vitit 1990 këmbët e mia për herë të parë shkelën në Shqipëri. E, ç'ndjenjë ishte ajo, vetëm unë dhe ata që e kanë pritur me pa durim e dinë...*

Ëndrra e viteve të arta rinore, duke shëtitur nëpër Shqipëri nëpër "livadhe me lule e lisa të gjatë", u thye po në momentin kur këmbët e mia shkelën në Shqipëri, në pikën kuftare Kapshticë ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Për fat të keq, e kam përshkruar edhe në shkrimet e mëhershme atë ndjenjë të trishtuar...

Megjithatë, synim kisha të takoja dy personalitete: shkrimtarin Petro Marko dhe aktoren Rajmonda Bulku.

Arsyeja pse kisha dëshirë ta takoja shkrimtarin Petro Marko ishte korrespondenca me letra që kisha pasur me të nga viti 1975 deri më 1981, kohë kur raportet me Shqipërinë, madje edhe ato kulturore, u bllokuan, u ndërprejnë.

Sidoqoftë, letrat dhe foton e tij te përmendorja e Skënderbeut me cigare në gojë, si dhe foton tjetër me familje: Petro, Safo, Jamarbëri dhe Aranita, i ruaja me mall, por

kurrënjehëre nuk më ka shkuar mendja se mund t'i takoja.

Ndërkaq, arsyeja pse dëshiroja ta takoja aktoren Rajmonda Bulku ishte e lazduara Meli në filmin "Zonja nga qyteti", por edhe në filmin "Vitet e pritjes" me rolin kryesor, film të cilin ma dha të incizuar në videokasetë im mik, Isa Thaçi, në Norvegji, pak muaj para se të shkoja në Shqipëri.

## SI E NJOHA RAJMONDËN?

Kur arritëm në Tiranë, bashkë me tim koleg, Rexhep Hajdarin dhe mikun tim të çmuar Sokol Mushkolajn nga Deçani, u vendosëm në banesën e një të afërmi të Rexhepit, meqë te ai Rexhepi kishte qenë edhe më parë. Na priti si është më së miri, ani pse ngushtohej se s'mund të na afronte atë që dëshironte, por skamja në atë kohë kishte depërtuar edhe te shtresa

më e pasur e qytetarëve...

Pas një dite të lodhur nga udhëtimi i gjatë, bëmë gjumë të mirë.

Të nesërmen, i them pronarit:

"Dy personalitete kam dëshirë t'i takoj – shkrimtarin Petro Marko dhe aktoren Rajmonda Bulkun dhe si mund t'i gjej?". "Petro Marko nuk e di ku e ka shtëpinë, kurse shtëpinë e Rajmonda Bulkut e di", më tha.

Dhe, pa e zgjatur shumë, hipëm në autobusin e qytetit që të shkonim te shtëpia e aktores...

Atë ditë binte shi i prajshëm, por po të ecje paksa gjatë në këmbë të lagte.

Autobusi ishte i vjetër, llom, aq sa uji pikonte mbi kokat tona, kure njerëzit i mbanin ombrellat hapur!

Kur arritëm në një stacion, miku ynë na tha – këtu duhet të zbrisim.

Dhe, kur dolëm nga autobusi, jo më larg se nja 100 metra kishte qenë shtëpia e



Rajmondës, shtëpi që dallonte edhe në pamje të jashtme nga shtëpitë përreth. I ramë zilit. Pas pak derën e hapi një grua paksa e moshuar.

E, kur i treguam kush jemi dhe arsyen pse e kërkojmë aktoren, ajo tha: "Unë jam vjehrra. Ja, tash e thërras Rajmondën!". Dhe, pa prituri gjatë në derë doli ajo, aktoria e madhe, Rajmonda Bulku, të cilën që nga momenti që e kisha parë për herë të parë në filmin "Zonja nga qyteti" kisha dëshirë ta takoja, të shkruaja për të. "Mirë se keni ardhur! Më tregoi vjehrra kush jeni. Urdhëroni brenda!", tha. Pas saj u ngjitëm shkallëve për në katin e dytë të shtëpisë.

Salloni i shtëpisë ishte i madh, me ca orendi, por jo edhe i ngarkuar me to... U ulem në kolltukët jo aq të rinj, por me shije, drugdhendje si në sallonet mbretërore.

Dhe, pas përshëndetjes së zakonshme, Rajmonda kërkoi falje se vetë duhej t'i bënte kafetë, sepse në shtëpi ishte vetëm me vjehrrën.

Kur arritën kafetë, ul në kolltukun e saj dhe nisëm bisedën për shkollimin e saj, rolet e para në aktrim, e deri te roli kryesor në filmin "Vitet e pritjes", film i cili ishte xhiruar vetëm një vit më parë.

Por, nuk mbetën anash as pyetjet për jetën e saj private, martesën me inxhinierin e arkitekturës, i cili në ato çaste ishte në punë, si dhe zhvillimit politik e që pas një kohe erdhi edhe deri te pluralizmi politik në Shqipëri.

E, krejt në fund, ajo u ngrit edhe një herë nga kolltuku i saj, e kur u kthye erdhi me



Rajmonda Bulku në vitet 90  
(pamje nga filmi)

pjatat e vogla me ëmbëlsirë, e që, siç tha, i përgatitë vetë.

## PSE NUK PATA FAT TA TAKOJA PETRO MARKON?

Në fund, para se të largoheshim nga shtëpia e saj, i tregova se kisha dëshirë ta takoja edhe shkrimtarin Petro Marko, sepse disa vjet me radhë kisha pasur korrespondencë me letra, konkretisht deri më 1981, kohë kur shpërthyen demonstratat e mëdha anë e mbanë Kosovës, e që pas asaj kohe u ndërpre çdo lloj bashkëpunimi...

Pa e zgjatur, më tha: "Nga një mik imi kam dëgjuar se Petroja nuk pranon askënd në shtëpi! Arsyeja është shëndeti i tij i ligë. Përndryshe, shtëpia e tij është jo larg nga këtu". Dhe, pas një hamendje ta kërkoja apo jo Petro Markon, vendosa të mos shkoja në shtëpinë e tij, meqë nuk kisha dëshirë ta shihja në gjendje të keqe.

Në anën tjetër, ndoshta edhe nuk do i kujtohej korrespondenca me letra që kemi pasur...

E, pas një viti, konkretisht më 27 dhjetor të vitit 1991, shkrimtari i madh, Petro Marko, largohet nga kjo botë.

Isa ILAZI



Guri i Plakës

## Ku ndodhet "Guri i Plakës"?

"Guri i Plakës" është një legjendë, tregim nga goja e popullit që ka lënë gjurmë!

Guri është çarë mes përmes nga një kompani franceze në vitin 1936, kur Jugosllavia e Versajës ndërtoi hekurudhën Prishtinë-Pejë, e cila edhe tash është e qarkullueshme.

"Guri i Plakës" është një monument natyror me karakter gjeomorfologjik, i cili gjendet në fshatin Dritan (Dobroshec) i komunës së Drenasit, rrëzë masivit malor të Çyçavicës.

Në vitin 2006 monumenti është vënë nën mbrojtje dhe i takon kategorisë së tretë.



# Oxhaqet pa tym në Prapashticë

*Një kohë Prapashtica i kishte afro 200 shtëpi e shkolla ishte e mbushur me nxënës. E sot?*

Sot, në Prapashticë të Prishtinës të rralla janë oxhaqet që nxjerrin tym. Edhe shitorja e vetme që punonte në fshat më nuk punon.

E, në mungesë të nxënësve, viti i sivjetmë shkollor nuk filloi në shkollën fillore të këtij fshati.

Andaj, edhe ata pak nxënës që janë, u desh t'ia mësyjnë kryeqytetit ose ndonjë shkolle tjetër që e kanë më afër...

Veterani i arsimit, ish-mësuesi Ilmi Uka, është ndër të rrallët banorë që mund të haset në Prapashticë, meqë 73-vjeçari, pavarësisht vështirësive, nuk e ka braktisur vendlindjen.

## Ç'THOTË BANORI ILMI UKA?

"Para luftime Prapashtica i ka pasur 92 shtëpi të banuara, kurse shkolla i ka pasur mbi 100 nxënës, edhe pse në vitin 1972, kur kam filluar punën si mësues, shkolla i ka pasur 149 nxënës.

Por, me ardhjen e luftës, fshatarët u shpërngulën dhe ikën prej këtu: Dikush në Maqedoni, dikush në Shqipëri. Pra, ku kanë mundur të gjejnë strehim...

E, me ardhjen e lirisë, me fitimin e luftës së UÇK-së dhe partnerëve tanë ndërkom-

bëtarë, sidomos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u bë e mundur që njerëzit të kthehen në fshat...

Por, sidoqoftë, rreth 30 për qind e fshatarëve nuk janë kthyer më në tokat e tyre.

Shembull, lagjja ime, "Lagjja e Cubajve", në prag të luftës i ka pasur 27 shtëpi të banueshme, ndërsa tash i kemi dy shtëpi!

Pra, shih në ç'gjendje ka ardhur fshati!?", thekson Ilmi Uka, kryetar i fshatit Prapashticë.

## ME ÇKA DO TË JETONIN TË RINJTË NË PRAPASHTICË?

Ilmiu, që ka qenë mësues dhe kryetar i Bashkësisë Lokale të kësaj ane, thotë se krahas mungesës së investimeve, në migrim ka ndikuar edhe ndryshimi i stilit të jetesës te të rinjtë.

Subvencionet për bujqësi, sipas tij, nuk i bindin të rinjtë të qëndrojnë, meqë, siç thotë ai, ata kanë të tjera ambicie.

"Hajde, të themi, se dikush prej rinisë do jetojë në fshat. Po e pranojnë që dikush do jetojë në fshat... Mirëpo, atë dashuri që do të kthehesh duhet ta përcjellësh me

diçka. Duhet ta përcjellësh me një bazë ekonomike, me një ndihmë nga shoqëria, me një investim, me një donacion që të fillojnë njerëzit prej zeros për ngritje. Ato kanë munguar në kohën e kaluar, megjithëse tash vonë jepen disa subvencione për blegtori e disa për hektarë të mbjellë me grurë ose me drithëra të tjerë, mirëpo janë pak dhe njerëzit e kanë humbur vullnetin.

Rinia më nuk merret me bujqësi. Duhet të pranojmë se është koha e teknologjisë dhe njerëzit më nuk duan me rrokë plugun, duan punë më të lehta, më komode. Pra, për shumëkënd fshati më nuk është atraksion...

Të jetosh në fshat, domethënë, je tërë ditën duke u angazhuar me punë, si në verë e dimër, sepse edhe dimri i ka punët e veta në fshat", shprehet Ilmi Uka.

## PËR FUND

Jeta në fshat ishte e mirë atëherë kur të gjithë i punon arat, kositnin livadhet, shkolin në male për dru, shkonin në mulli për të bluar etj.

Mirëpo, sot të rinjtë nuk merren me këto gjëra, sepse synimi i shumë të rinjve është qyteti, madje edhe më larg – Perëndimi...





Reserve your date now on +355 69 80 30 888  
Adress: "George W Bush", Tiranë, Albania

 /thecrown\_tirana





# Turr pas dashnoreve mbeta pa u martuar!

*Këto ditë i mbushi 48 vjet dhe ende nuk kam pranë vetes ndonjë femër serioze për martesë. Kam pasur shumë lidhje të shkurtra me vajza, por jo edhe gjatë.*

Jam i lindur e rritur në Prizren. Në kohën e studimeve kam banuar në Prishtinë. Dhe, thënë të drejtën, nuk kam hequr për femra, sepse i vardiseshja sa një femre sa një tjetre.

Femrat i njihja, kryesisht, në ligjërata, por edhe në oborr të fakultetit. E mira ishte se unë nuk kisha problem me para, sepse babai im, qëkur isha fëmijë, kishte një argjendtar dhe puna i shkonte mirë.

## **MOS I ÇMEND FEMRAT!**

Ishte fakt se femrat shumë shpejt binin në dashuri me mua.

Kur shikohesha para pasqyrës, e lëmoja fytyrën, duke i thënë vetes: "Hej, njeri, i çmende femrat!"

Por, aso kohe nuk e dija të vërtetën: ato më kishin dashuruar veç se kisha para... Dhe, kur i kujtoj ato çaste, habitem se kur pata kohë për të mësuar...

## **...POR KALOI EDHE AJO KOHË!**

Sot ndodhem para një udhëkryqi të madh: Si t'ia bëj me martesë?

Vetëm për një gjë mburrem: secila femër që e kam pasur ishte më e bukur se tjetra... Më së shumti gëzohesha kur ndahesha nga një femër e bëja turr pas një tjetre... Tashmë nuk dua t'i kujtoj më gjatë ato vjet, sepse dashnoret më lanë pa u martuar.

Prandaj, dua të bëj një ndryshim në jetën time: ta gjej një femër që të martohej, pa e pyetur fare sa frajera i ka pasur para meje, sepse i tillë kam qenë...

**Jamin D., Prizren**





# **BATTLE ROPE**

**CARDIO  
STRENGTH  
ENDURANCE**

**POWER  
HOUSE**

FEEL POWERFUL. JOIN OUR HOUSE



# Nuk e takoi kurrë Merilin Monronë e u varrosë pranë saj!

*Themeluesi i “Playboy”-t, Hugh Hefner, edhe pse nuk e takoi kurrë personalisht Merilin Monronë, vendosi që kur të vdesë të varrosej pranë saj, duke shkaktuar reagime të shumta...*

Hugh Hefner, i cili u nda nga jeta në shtator të vitit 2017, në moshën 91-vjeçare, pagoi 75 mijë dollarë për varrin pranë aktorese së njohur Merilin Monro.

## KUR E BLEU VARRIN DHE PSE?

Varrin pranë saj Hugh Hefner e bleu në vitin 1992, në varrezat “Westwood Village Memorial Park”, duke arsyetuar se Monro ishte ikona që lansoi “Playboy”-n.

Në një intervistë në vitin 2012, ai tha:

“Ndjej një lidhje të dyfishtë me të, sepse ajo ishte çelësi për fillimin e “Playboy”-t.

Në anën tjetër, kemi lindur në të njëjtin vit”.

## PSE PAT REAGIME TË SHUMTA?

Zgjedhja e tij që të varroset pranë Merilin Monrosë u konsiderua e diskutueshme, duke pasur parasysh obsesionin e tij ndaj Merilin Monrosë, të cilën nuk e kishte takuar kurrë personalisht.

Merilin Monro ishte personi që lansoi në thelb suksesin e “Playboy”-t, meqë ajo u shfaqë në kopertinën e edicionit të parë të revistës në vitin 1953. Megjithatë, ajo nuk e kishte dhënë pëlqimin për publikimin e fotove të saj nudo, të cilat ishin bërë për një kalendar për vetëm 50 dollarë. Në autobiografinë e saj, ajo ka deklaruar:

“Nuk kam marrë kurrë një falënderim të vetëm nga të gjithë ata që kanë bërë miliona nga fotot e mia nudo! Madje, më duhej të blija një kopje të revistës për të parë veten!”.



# BOOM



**Gresa jep arsye  
pse duhet votuar**

**Arbër Behluli për deputet:**

**I shkolluar, punëtor,  
me të kaluar  
të pastër si loti**



## Gresa jep arsyen pse duhet votuar Arbër Behluli për deputet: I shkolluar, punëtor, me të kaluar të pastër si loti

*Gresa Behluli është rritur me këngën e skenën, duke u bërë shpejt pjesë e listës të artistëve më të pëlqyer në vend.*

*E njohur për talentin, këngët, paraqitjen dhe faktin se karriera e saj nuk është përshkuar asnjëherë nga skandalet.*

*Larg zhurmave e kaosit të shou-bizit, Gresa Behluli ka ndërtuar një karriera të shkëlqyer dhe të admirueshme.*

**Gresë, duket sikur një jetë je në skenë e nuk ke ndryshuar fare. Si është e mundur?**

- Paraqitja është pjesë e profesionit. Gjithmonë kam qenë e kujdesshme për imazhin tim.

Mundohem të jetoj shëndetshëm, duke i kushtuar rëndësi ushqimit.

Më duhet të them se qetësia e brendshme është tejet e rëndësishme dhe gati esenciale për të reflektuar, por edhe për t'u dukur mirë.

**Cili është raporti yt me rutinat shumë të famshme për kujdesin e lëkurës, të pamjes së jashtme?**

- I kushtoj mjaft rëndësi mirëmbajtjes së lëkurës, nuk më ndodh asnjëherë të fle me grim edhe nëse kthehem në shtëpi pas një dasme apo koncerti në

katër të mëngjesit.

Për mua pastrimi i lëkurës është domosdoshmëri. Pi ujë shumë, ushqehem shëndetshëm dhe, mbi të gjitha, e mbaj balancën në të ushqyer.

**A je munduar ndonjëherë për të bërë ndryshime të mëdha në pamje?**

- Ka pasur periudha kur jam munduar nga trendet sezonale, por prapë i kam qëndruar stoike pamjes time natyrale dhe jam tejet e lumtur për këtë gjë, sepse bukuria individuale është më e çmuar sesa trendet e momentit.

**Cili është ndryshimi më i guximshëm?**

- Nuk jam edhe aq e guximshme në këtë aspekt. Konsideroj që ndryshimi më i guximshëm ka qenë kur i kam bërë





flokët të kuqe. Ndoshta i bëj prapë!

**Si bashkëshorte, nënë dhe këngëtare shumë e angazhuar, a mendon se ke mjaft kohë për veten?**

- Është mjaft sfiduese, sidomos si nënë, meqë kujdesi dhe rritja e një fëmije kërkojnë impenjim serioz, madje edhe lojëra me Diellin.

Duhet të luaj me të si shoqe, në mungesë të një motre a vëllai...

Gjithsesi, koha më cilësore është ajo që e kaloj me djalin tim, i cili po rritet shumë shpejt, andaj po e shfrytëzoj.

E di që do të vijë dita që Dielli dikur nuk do të ketë edhe aq kohë për mua... (qesh).

**Dielli është dielli i jetës tënde. Sa të ngjason?**

- E vërtetë, e kam diell të jetës dhe të çdo dite. Më ka ngjarë edhe në pamje, edhe në karakter. Shoh që fëmijët marrin shumë edhe nga shprehitë e prindit.

Dielli është i dashur, sepse është i rrethuar veç me dashuri dhe të njëjtën na dhuron gjatë gjithë kohës.

**Diçka që e dallon nga fëmijët tjerë?**

- Për secilin prind, fëmija i vet është më i miri e më i bukuri në botë. Dielli është hiperaktiv dhe shumë kurioz.

**Edhe sa duhet të presë publiku për një këngë tënden të re?**

- "Kujt i thua" është balada ime e fundit që e kam publikuar në dhjetorin që shkoi dhe tash jam në përgatitje të tri këngëve të reja.

Do të kem edhe bashkëpunime e potpuri për dasma.

**Këngët që të përfaqësojnë më së miri?**

- Këngët "Zemra ime", "Kujt i thua" etj.

**Ti këndon live. A është e lodhshme apo krijon ndjenja reale të të qenit në skenë, të qenit këngëtare?**

- Nëse nuk këndon live, nuk je artist. Thjesht, je performues dhe fyen publikun që vjen për të përcjellë.

Patjetër, është shumë e lodhshme, por kjo e bën më reale lidhjen publik-artist.

Por, më duhet të them se eksperiencia e lehtëson punën dhe pakëson lodhjen.

**A bën të flasim pak edhe për politikë, meqë jemi në kohë fushate?**

- Po, gjithsesi, sepse jeta jonë diktohet prej politikës.

**Si e ke pritur vendimin e Arbrit për kyçje në politikë?**

- Shumë mirë. Jam tejet e lumtur që Arbri është kyçur në politikë, në profesionin e vet.

Inkuadrimi i tij në politikë nuk është i rastësishëm, sepse vjen pas një shkollimi dhe pune shumëvjeçare. Pa dyshim, kisha dashur të shohë më shumë djem e vajza si Arbri të jenë zëri ynë në Kuvendin e Kosovës...

**Të kemi parë duke i dhënë Arbrit mbështetjen tënde. Pse duhet votuar Arbri?**

- Është i arsimuar, i përgatitur, ka përvojë pune, është i ri dhe ka shumë vullnet për punë.

Është rritur me vlera e atdhedashuri. E, njerëzit e tillë e bëjnë diferencën. Arbri e ka të kaluarën të pastër si loti, të panjolllosur...

**Në një familje të dominuar nga persona publikë, Arbri duket më i tërhequri. Si mendon se do ta përballojë jetën publike?**

- Ai nuk po i hyn politikës për t'u bërë person publik, sepse po të ishte kështu do ta kishte shumë lehtë - veç do bënte foto me nënën apo me mua... Hyrja e Arbrit në politikë është mision.

**Të faleminderit! Ishte kënaqësi për këtë intervistë të veçantë!**

- Ju faleminderit juve!

**Nderim Neziri**



“Burrin e kam persian, por jemi njëjtë!”

*Modelja e njohur Emina Cunmulaj ditë më parë ka bërë me dije se si çift me milionerin persian Sam Nazarian, e që i kanë 3 fëmijë, kanë diskutime, por janë në një pikë ku kanë kuptuar se për çfarë ja vlen të debatojnë dhe për çfarë jo...*



“Sam është një tip alfa dhe unë jam alfa. Në fillim e kam pasur të vështirë të përshtatem, por tani e kam kuptuar se për çfarë situatash ja vlen të debatosh dhe për çfarë duhet të tërhiqesh mbrapa”, shprehet Emina. Ndër të tjerash, ajo shtoi se burrin e saj e ka mbështetje për bamirësitë që bën, edhe pse vetë nuk përzihet në biznesin e tij.

“E kam mbështetje. Ai rrjedh prej një familje filantropike. Ata kanë fondacionet e tyre, me qindra miliona japin për bamirësi, por unë vetë nuk marrë pjesë, sepse kam rrugën time, pa lidhje me burrin tim, meqë jam tip që kur marrë një punë dua ta përfundoj vetë”.

Emina theksoi, gjithashtu, se edhe pse bashkëshorti i saj nuk është shqiptar, kulturat janë njësoj, teksa u shpreh se: “Nuk mund t’i ndajë assesi sa i përket kulturës”.

“Burrin e kam persian dhe kam kuptuar një gjë që s’ka lidhje prej cilës anë të botës je, disa gjëra njerëzore janë të njëjta në të gjitha anët e botës. Unë persianët dhe shqiptarët nuk mund t’i ndaj assesi sa i përket kulturës. Pothuajse jemi njësoj”, tha Emina.



# BOOM

*business*

A man with a beard and long hair, wearing a dark suit, is sitting on a wooden stool in a dimly lit bar. He is holding a cigar in his right hand and a bottle of Don Amaro liqueur in his left. The bar is decorated with green plants, hanging purple flowers, and several bottles of Don Amaro are displayed on a wooden counter in front of him. The background shows a bar counter with various bottles and a blue neon light.

**Biznesmeni më unik shqiptar,  
Jimmy Arbëri, godet me "Don Amaro",  
pija që do të pushtojë botën**

## Biznesmeni më unik shqiptar, Jimmy Arbëri, godet me "Don Amaro", pija që do të pushtojë botën

*Jimmy Arbëri është biznesmen shqiptar, i cili që 30 vjet është i njohur në fushën e gastronomisë dhe patundshmërisë. I afirmuar si njeri i fuqishëm në botën e biznesit në Zvicër, Jimmy Arbëri, gjithashtu, njihet për jetën luksoze dhe stilin e rafinuar. Së fundi, Jimmy ka lansuar edhe pijen e tij të personalizuar, të quajtur "Don Amaro" (liker pjesërisht i ëmbël i cilësisë së lartë). Për më shumë, lexoni intervistën me një prej personazheve më unik shqiptar...*





**Jimmy, njiheni si një njeri i suksesshëm, biznesmen me emër. Si nisi gjithçka?**

- Gjithçka nisi para 30 vjetësh kur erdha në Zvicër. Fillimisht bëja punë të rënda, pastaj nisa të merresha me gastronomi, ku edhe filluan sukseset. Ndërkohë, para 25 vjetësh fillova të punoja edhe në fushën e paturndshmërisë, që është punë mjaft profitabile dhe, njëkohësisht, atraktive.

**Cili është triumfi më i madh yti në botën e biznesit?**

- Ka disa triumfe e fitore, por më duhet të them se secila prej tyre, pos që sjell kënaqësi të madhe, është shoqëruar edhe me sfida të ndryshme. Kam përjetuar suksese e triumfe, sidomos në "Real Estate".

**Cili është biznesi juaj më i njohur?**

- Aktualisht në "Real Estate" jam më aktiv dhe i dedikohem më shumë.

**Këshilla më e vlefshme që ke marrë gjatë ngritjes tënde si biznesmen?**

- Që të punoj me nder dhe korrektësi. Në të vërtetë, ky ka qenë dhe është parimi im në jetë dhe në punë.

**Po ti, çfarë i këshillon ata që duan të merren me biznes?**

- Të kenë kurajë, ta bëjnë punën që duan dhe të mendojnë se i bënë të lumtur. Nuk bën, assesi, t'u ikin qëllimeve dhe vizioneve! Duhet të besojnë në vetveten e aftësitë e tyre, sepse vetëm kështu do ta shohin dritën e suksesit...

**Nëse nuk do të bëheshit afarist, me çfarë do të ishit marrë?**

- Do të merresha me art, dizajn dhe arkitekturë. Këto janë fushat që më pëlqejnë, inspironë dhe

më shkojnë.

Sidoqftë, mendoj se nëse nuk do të merresha me punën që bëj që 30 vjet, ndoshta do t'i dedikohesha artit ose arkitekturës, apo të dyjave paralelisht.

**Dukeni mjaft avangard dhe unik. Nga është i frymëzuar stili juaj?**

- Frymëzohem nga stili dhe moda italiane. Eleganca dhe fryma e rafinuar që përcjellë shija italiane janë plotësisht në shijet e mia.

**Së fundi, ju shohim të shoqëruar në tavolina nga pija juaj e personalizuar. Pak më shumë detaje?**

- Po, është një amaro tejet e veçantë, e bërë nga 22 bio-melmsa, një liker super kualitativ "Premium class" dhe quhet "Don Amaro". Ka shishe e dizajn tejet të bukur, elegant e me gravurë.

Sidoqftë, kemi punuar dy vjet derisa kemi ardhur te rezultati i duhur...

"Don Amaro" është një pije pjesërisht e ëmbël me shije shumë të mirë, që mund të shijohet nga femrat dhe meshkujt.

**A gjendet edhe në Kosovë "Don Amaro"?**

- Likeri së shpejti do të jetë edhe në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi. Ekskluzivitetin e ka marrë firma e njohur "GEKOS".

**Nga të erdhi frymëzimi ta krijosh "Don Amaron"?**

- Më pëlqejnë shumë amarat, sidomos kur i shoqëroj me një puro. "Don Amaro" është definitivisht më e mira që mund të gjendet në treg...

**Kush ose çka ju plotëson në jetë?**

- Gruaja ime e bukur Viki dhe dy djemtë e mi: Dioni dhe Dalini.

**Suksese!**

- Të faleminderit!

**Nderim Neziri**



*Orbico Group dhe Authentic Brands Group  
nënshkruajnë partneritet afatgjatë  
për të rritur biznesin e markës  
Champion në të gjithë EMEA*





## *Pronari i ri i Champion lidh partneritet me Operatorin Lider të-markave për rritje kyçe regjionale.*

Zagreb, Kroaci dhe Nju Jork, Nju Jork – 11 dhjetor – Orbico Group (Orbico) dhe Authentic Brands Group (Authentic), një platformë globale për zhvillimin dhe licencimin e markave, njoftuan sot një partneritet të ri licencimi për markën ikonike Champion. Kjo aleancë strategjike hedh themelet për një bashkëpunim afatgjatë që do të hap mundësi të reja për rritje dhe zhvillim për Champion dhe të dy kompanitë në të gjithë zonën EMEA. Nëpërmjet marrëveshjes me Authentic, Orbico ka hyrë në një marrëveshje për licensë 10-vjeçare (me mundësi vazhdimi) për markën Champion për Evropën, Lindjen e Mesme dhe Afrikën me Authentic, si dhe për të zhvilluar gjithashtu njësi juridikedhe dyqane me pakicë të Champion Europe të cilat operojnë aktualisht në EMEA, subjekt i miratimeve të kërkuara rregullatore.

Champion Europe, me seli në Carpi, Itali, aktualisht operon në 36 vende, punëson më shumë se 1,300 njerëz dhe ka më shumë se 90 dyqane me pakicë në të gjithë rajonin. Kompania planifikon të zgjerojë më tej praninë e saj në të gjithë Evropën në vitet e ardhshme. Për Orbico, ky partneritet strategjik është një trampolinë për zgjerimin e operacioneve të saj në të gjitha tregjet evropiane. Orbico do të shfrytëzojë ekspertizën e saj dhe përvojën prej dekadash në distribuimin e markave globale për të përmirësuar biznesin e fortë të Champion në shumë tregje kyçe.

Edward Malky, Chief Business Officer Beauty, Style and Salon Professional në Orbico Group tha: "Ne e kemi njohur ekipin Authentic për shumë vite dhe kur u shfaq mundësia për të marrë Champion, thjesht kishte kuptim ta bënim këtë së bashku. Ky partneritet shënon një moment historik të rëndësishëm për Orbicon pasi ne zgjerojmë kategorinë e stilit sportiv në një shkallë më të madhe ne jemi të entuziazuar të përdorim ekspertizën tonë për ta ndihmuar atë të rritet edhe më shumë".

Henry Stupp, President Rajonal, EMEA dhe India – Lifestyle, tha: "Champion është një qendër e fuqishme në Evropë, me një biznes të themeluar dhe një përkushtim thellësisht besnik. Qënga momenti që blemë markën, Evropa ishte qendrore për strategjinë tonë dhe identifikimi i partnerit të duhur për të nxitur rritjen e saj ishte jetik. Orbico ka prevlaur si zgjedhje e fuqishme, falë ekspertizës së tyre të pashembullt dhe suksesit të dëshmuar me markat e klasit botëror.

Ky partneritet përfaqëson një hap përpara në rrugëtimin e Champion dhe ne kemi besim se së bashku, ne do të lartësojmë praninë e markës në të gjithë EMEA, duke përçar trashëgiminë e saj dhe duke e bërë atë një simbol modern të inovacionit dhe stilit sportiv".

Orbico është dëshmuar si një lider i provuar në ndërtimin e partneriteteve të forta, ekskluzive me markat e njohura botërore, duke e bërë këtë qasje një pjesë integrale të filozofisë dësstrategjisë së biznesit të kompanisë për rritje dhe sukses afatgjatë. Kjo formulë e provuar e suksesit ka qenë efektive përmë shumë se 30 vjet, e ilustruar nga bashkëpunimet e suksesshme me markat globale si P&G, PMI, Kellogg, Coty dhe të tjerë. Vitet e fundit, Orbico është fokusuar në mënyrë strategjike dhe ka operuar me sukses në kategorinë Sports Style, duke u bërë një distributor ekskluziv për disa prej markave kryesore të këpucëve në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë Converse, Dr. Martens, Merrell dhe On në të tjerë. Ky sukses e ka motivuar më tej kompaninë të eksplorojë kategori të reja dhe të zgjerojë biznesin e saj në rajone të ndryshme gjeografike

## **PËR AUTHENTIC BRANDS GROUP**

Authentic Brands Group (Authentic) është një platformë e unifikuar që integron M&A, strategjinë e markës, kreativitetin dhe inovacionin dixhital për të zhbllokuar fuqinë e portofolit të saj global. I lidh markat ikonë sportive, stilin e jetës, argëtimin dhe mediat me partnerët më të mirë për të optimizuar vlerën afatgjatë në treg. Duke gjeneruar më shumë se 32 miliardë dollarë në shitje globale

vjetore me pakicë, markat e Authentic kanë një gjurmë të gjerë të shitjes me pakicë në 150 vende, duke përfshirë mbi 13,000 dyqane dhe dyqane të pavarura dhe 400,000 pika shitjeje. Portfolio i markës së Authentic përfshin Shaquille O'Neal, David Beckham, Sports Illustrated, Dr. J, Greg Norman, Neil Lane, Thalia, Marilyn Monroe, Elvis Presley, Muhammad Ali, Reebok, Champion, Brooks Brothers, Barneys New York, Judith Leiber Couture, Ted Baker, Hunter, Vince, Hervé Léger, Frye, Nautica, Juicy Couture, Vince Camuto, Lucky Brand, Aéropostale, Forever 21, Nine West, Sperry, Rockport, Eddie Bauer, Boardriders, Quiksilver, Billabong, Roxy, DC Shoes, RVCA, Spyder, Volcom, Prince, Van Heusen, Hart Schaffner Marks dhe Thomasville.

Për më shumë informata, ndiqni [authentic.com](http://authentic.com).

Ndiqni Authentic në LinkedIn, Instagram, X dhe WeChat.

## **ORBICO GROUP PREZENTIMI**

Orbico Group është një distributor lider në Evropë, që operon në 24 vende dhe u shërben mbi 400 milionë konsumatorëve. E themeluar në Zvicër në vitin 1987 dhe në pronësi të Branko Roglić, Orbico është rritur për t'u bërë një partner ibesueshëm për markat globale në gjashtë sektorët kryesorë të biznesit: FMCG, Bukuri, Style & Salon Professional, Supply Solutions & Services, dhe Turizëm. Me një ekip prej më shumë se 9,000 punonjësish, kompania është e përkushtuar të ofrojë zgjidhje inovative dhe të nxisë partneritete afatgjata, të drejtuara nga vlera.

Misioni i Orbico është i përqendruar rreth bashkëpunimit, duke bashkëpunuar me furnitorët dhe klientët për të fituar konsumatorët. Kompania njihet si partneri i zgjedhur, duke ofruar zgjidhje të përshtatura për të përbushur nevojat në zhvillim të bazës së saj diverse të klientëve. I nxitur nga një angazhim për rritje të qëndrueshme, Orbico vazhdon të lulëzojë si një shpërndarës i së ardhmes, duke shfrytëzuar ekspertizën dhe fleksibilitetin për të siguruar sukses në një treg që ndryshon me shpejtësi.

# Vjehrra kallet pse s'po rri me të!

*Jam Drenusha, 25 vjeçe, nga Mitrovica, e martuar në Prishtinë. Im burrë është 33 vjeç dhe ka firmë të veten, ku edhe e kalon pothuajse tërë ditën në punë. E, unë me vjehrrën tërë ditën gju më gju, siç thuhet te ne.*

*Por, problemi është se sado që mundohem t'ia bëj kafënë me kohë, të fshij e laj, ajo prapëseprapë është e pakënaqur me mua...*

Zgjothem herët në mëngjes dhe e përcjell tim burrë për në punë. Ai ka firmë dhe thuhet tërë ditën e kalon në punë. Unë e vjehrra jemi "inventari i shtëpisë" ag e terr.

Dhe, meqë jemi vetëm ne të dyja pothuajse tërë ditën, mundohem t'i shërbej si duhet, si edhe i takon t'i shërbejë nusja vjehrrës.

Por, përkundër përpjekjeve të mia që t'ia bëj me kohë kafënë e mëngjesit, pastaj kafallin, të fshij, pastroj e laj, prapëseprapë nuk është e kënaqur me mua!

Shpeshherë më thotë edhe fjalë të rënda që nuk i meritoj: gjumashe, demelicë, e interesuar vetëm të shëtisë..., e të tjera të ngjashme, edhe pse asnjëra prej fjalëve të apostrofuara nuk kanë të përbashkëta me mua.

E para, unë zgjothem herët dhe e përcjell tim burrë për në punë. Pra, nuk jam gjumashe.

E dyta, me kohë ia bëj kafënë e mëngjesit dhe kafallin, kurse gjatë ditës laj, pastroj, fshij... Pra, nuk jam demelicë.

E treta, rrallëherë dal në qytet, madje vetëm kur kam për të blerë diçka. E, shumë më rrallë dal me ndonjë shoqe në kafe. Pra, nuk jam prej atyre që dalin çdo ditë në kafe a në shëtitje me shoqe a shok.

## E KONSIDERON VETEN TË PAZËVENDËSUESHME!

E vërteta është se ajo di t'i përgatisë mirë drekat e darkat dhe nuk përton. Kur unë dua të përgatis ndonjëherë drekën, më afrohet afër dhe në vend se t'më këshilloj - më qorton, e kjo më nevrikos!

A ishte e tillë gjithmonë?

Jo, në fillim të martesës sime ishte krejt ndryshe. Ishte e qeshur, kishte qëllime të mira.

Por, sa më shumë kalon koha, aq më shumë ndërhyt në jetën time, duke më dhënë këshilla të padëshiruara dhe të papërshtatshme kinse nuk po rri sa duhet me të...

Dhe, po qe se i "kundërvihem", qoftë edhe me ndonjë fjalë të lehtë, zakonisht ma "punon" pas shpine, duke spiunuar te djali i saj (te burri im) kinse nuk po e respektoj sa duhet...

## CILI ËSHTË FAJI IM?

Kur ndalem e mendohem mirë e mirë, shoh se edhe unë kam faj, që ajo nuk do ma falë kurrë: la kam marrë personin më të çmuar dhe më të rëndësishëm të jetës së saj, fëmijën e saj, sepse për të ai gjithmonë ka qenë dhe do të mbetet fëmija i saj! Por, në anën tjetër, nuk e fajësoj edhe aq shumë veten, sepse im burrë vetë më ka zgjedhur për grua?

**Drenusha, Prishtinë**





# Romantic ESCAPE

What if you could escape the ordinary  
and enter world of wonder and romance?

ALL **14.000** pax

INCLUDING:

**SEA VIEW ROOM  
BREAKFAST & DEGUSTATION DINNER  
LUXURY SPA EXPERIENCE**

For more info & Reservations

Rr. "Aleksandër Moisiu", Vlorë, Albania | +355 69 604 1000 | [info@marinabay.al](mailto:info@marinabay.al)



# Krejt Kosova në vaj se u nda profesori e profesoresha!

*Kohë më parë një profesor, që e kisha fqinj, me gruan profesoreshë u ndanë, edhe pse ishin prindër të tre fëmijëve. Gjyqi për ndarjen e tyre mbahej në Viti. Por, lajmi mori dhenë në tërë Kosovën. Pse?*

U nda filan profesori e filane profesoresha. Gjyqi ishte publik dhe mbahej në Viti. Shkuan njerëz të fqinjëve për të marrë pjesë në gjykim, më shumë për të mësuar se çka ndodhi, çka i ndau... Dhe, kur u bë ndarja edhe me gjyq, më kapluan lotët, sepse gjithmonë i kam menduar si çift i përsosur. Por, për çudi, lajmi nuk mbeti i lokalizuar, por u shpërnda në gjithë Kosovën... Ngjarja pat ndodhur para lufte, kohë kur edhe nuk kishte shumë ndarje si tash, përndryshe tash askush s'do të merrej me këtë punë! Divorci i tyre shumëkënd e bëri me lot, veçmas kur i shihnim fëmijët e tyre tek shkonin sa te njëri prind sa te tjetri... Sidoqoftë, rasti ishte traumatizues, sepse u ndanë bashkëshortët që kishin fëmijë, e që për kohën ishte e pabesueshme. Përndryshe, tash ndahen, përsëri bashkohen e përsëri ndahen dhe kush dert s'e bënë... Madje, ka çifte që edhe bashkëtojnë. Me nga disa vjet janë bashkë dhe në fund ndahen me fjalët se nuk paskan qenë për njëri-tjetrin...

Kështu, kur i dëgjon prindërit teksa thonë se po u bashkëjeton vajza a djali me dikë, duket sikur nuk ka asgjë jonormale. Por, kur analizon se ata bashkëtojnë e një ditë ndahen për pikë qejfi, kjo nuk tingëllon mirë, nuk tingëllon si diçka normale...

## I URRENTE KAÇANIKU KUR I SHIHNI DORË PËR DORË!

Kanë kaluar shumë kohë qëkur kishte ndodhur shëtitja e parë dorë për dorë e dy të rinjve në Kaçanik. Axhib Tusha më pat thënë se ishte i pari në Kaçanik që kishte shëtitur dorë për dorë me të dashurën e tij. "Çka e ke kapur përdore, bre djalë, a po ta merr kush, a?!", kishte pasur të tillë që i kishin thënë në rrugë. Por, Tusha kishte shikuar punë e vet... Mirëpo, as familja nuk e kishte pritur mirë këtë punë, andaj i kishin sjellë një nuse në shtëpi! Një grua të kohës, siç thoshin në atë kohë. "Kur ma sollën gruan m'u prish qejfi

shumë, ama duhej respektuar "ligjin e kohës!", më thotë ai. Sidoqoftë, edhe ndaj gruas që ia kishin sjellë në shtëpi nuk ishte sjell keq, ani pse nuk ishte grua me dashuri... "Më shumë nuk kam mundur të bëj, ama i kam thënë se nuk e dua!", më pat treguar ai në bisedën tonë. Sidoqoftë, kohët ndryshuan. Sot rinia shëtisin, puthen e përqafohen nëpër Kaçanik si çdo kund tjetër dhe askush nuk ua lëshon sytë. Por, që kjo të ndodhë, është dashur të kalojë gjysmë shekulli jetë dhe pritje. Dhe, në pritje është plakur një gjeneratë e tërë. Kanë kaluar 50 breza shkollorë, të cilët kanë luftuar në mënyra të ndryshme për emancipim... E, kur këto gjëra tash i shikon nga prizmi i së kaluarës, është një punë nostalgjie për diçka që e kemi përjetuar e nuk e kemi më. Pra, ngjashëm si odat që i kemi pasur e nuk i kemi më... Mirëpo, nuk i kemi as burrat...

S. M.



Oferta vlene deri me 15 Shkurt

**30%**  
**ZBRITJE**  
RIMODELIMI I GJINJËVE

Manaderm

*Shën Valentini*

**SUPER ZBRITJE**

Na ndiqni për detajet dhe përgatituni për një befasi të paharrueshme!

# Ishim, s' do të jemi kurrë më!

*Ishim bashkë, të lumtur. Të dashuroja shumë. Ishe në mendjen time, në shpirtin tim. Ishe gjëja më e bukur që ndjeja në zemër...*

Çdo moment që kaloja me ty e zbuloja se ishte unik, shumë special, e unë doja të isha vetëm e jotja, ta jetoja jetën me ty...

Dhe, ti më thoshe se më doje, se te ti e për ty isha e vetmja dashuri e madhe e jetës tënde...

Por, një ditë e kuptova se nuk ishte ashtu, meqë nisa të të bëhesha bajate, monotone, kinse kërkoja shumë nga ti!

Këto gjëra më dhanë të kuptoja se në sytë e tu s'kam pasur vlerë fare, kam qenë e parëndësishme për ty. Atë ditë të mallkuar, kur edhe i kuptova këto, ti vrave shumë iluzione, dashurinë, besimin, respektin.

Atë ditë kur përfundoi çdo gjë, ajo nuk më vrau, më bëri më të fuqishme, por diçka brenda meje vdiq, vdiq sepse jetova në një gënjeshtër, se ajo

që kam besuar se do ta kem nuk ishte ashtu, çdo gjë ishte e rreme...

Ishte një përjetim trishtues për mua,

por dhe një e vërtetë, një realitet i vështirë me shumë dhimbje... Dhe, nga ajo ditë mbeta vetëm me kujtimin tënd!

Andaj, edhe përfunduar ashtu si filluam: pa u njohur! Kështu, pra, ka ardhur

koha kur unë duhet ta pranoj se ishim, s'jemi dhe s' do të jemi kurrë më...

**Sidrita, Gjilan**

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**Shkabaj** për Android

ANDROID APP ON  
**Google play**

**Shkabaj**  
FITO KËTU

www.shkabaj.net



Revolucion në  
**DOBËSIM**  
Worldwide franchise



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë.  
Rrugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë.  
Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm.  
Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke pëmbushur ëndrrat e tyre.



39kg 36 sesioni



79kg 30 sesioni



89kg 20 sesioni



119kg 20 sesioni

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

teksa bëhesha kinse flija, burrit i cingëroi telefoni dhe nisi të flasë ngadalë me dikë, e që, me siguri, ka qenë motra ime...

Vazhdova të bëhesha kinse flija, në mënyrë që të zbuloja diç nga ajo bisedë, por ai fliste ngadalë dhe nuk mund të kuptoja për çka flisnin... Sidoqoftë, motra jeton ende te babai dhe ka pasur një fejesë të dështuar...

**"E tradhtuara"**

### Përgjigje:

*Situatat njerëzore janë si sëmundjet klinike. Kështu, te ju është ftohur marrëdhënia me burrë, por nuk ka "vdekur".*

*Andaj, ato që kanë ndodhur do të kalojnë, sepse edhe ti, në njëfarë mënyre, je e vetëdijshme se ata nuk kanë asgjë ndërmjet veti, se gjërat nuk kanë kaluar në përjetime edhe nëse kanë pirë kafe bashkë...*

*Këshilla ime është: Ruaje burrin, sepse në këtë mënyrë e ruan edhe familjen tënde të vajzërisë!*

### Pse ndihem e pasigurt?

Jam nënë e 4 fëmijëve. Jetoj në Zvicër. 66 vjet i kam mbushur. Po bëhen disa vjet që më ka vdekur burri.

Por, sa herë që e kujtoj burrin më kaplon një frikë!

Si ta kaloj këtë gjendje?

**"Shqiptarja e Zvicrës"**

### Përgjigje:

*Mendo për jetën me fëmijë, reja, nipa e mbesa. Kjo është dhurata që ta ka falë Zoti.*

*Dhe, nëse i kujton këto gjëra vazhdimisht, e kupton se njeriu ashtu sikur vjen si një dhuratë në botën e dritës, dorëzohet në ditën e fundit të jetës te Zoti i madhërisëm...*

*Kështu, do ta kesh më lehtë dhe frika do të të zbehet vazhdimisht...*

### Dua të ndahem nga burri!

Jam zonjë 40 vjeçe, jetoj në Ferizaj.

### A do të kthehet vajza në shtëpi?

Jam një nënë me shumë halle, por kjo e fundit më ka shtrirë përtokë. Që nga viti 1990 jetoj në Suedi. Problemi është se vajza herë pas herë ik, shkon te një burrë i martuar dhe nuk kthehet me javë të tëra...

Sipas ligjit, jemi të pafuqishëm ta largojmë prej tij.

Çka të bëjmë?

**"Qama"**

### Përgjigje:

*Vajza ka dalë nga shtëpia pas shumë problemeve tuaja bashkëshortore.*

*Në fakt, ti me burrin keni probleme.*

*Vajza të ka thënë shumë herë ose lini problemet ose dal prej shtëpi.*

*Pra, këtë e di që moti...*

*E, ti me burrë, shkakun i inateve ndërmjet veti, vazhdonit me teket tuaja.*

*Ndërkaq, a do të kthehet vajza a jo, varet nga jeta juaj bashkëshortore.*

*E, në jetën tuaj bashkëshortore nuk më takon të përzihem...*

### A po më tradhton burri?

Jam 43-vjeçare, jetoj në Drenas.

Arsyeja pse të shkruaj është dyshimi se burri po më tradhton...

Dyshimin e mbështes te fakti se para pak kohësh ia pashë në telefon disa foto intime.

Mendoj se po me tradhton me punëtoren e vet.

A ka dyshime?

**"Dashuria e venitur"**

### Përgjigje:

*Të drejtë dyshimi ke, por dyshimi nuk është argument!*

*Sikur ta kishe pa burrin tënd me atë femër që thua se e kishte foton e saj, ajo jep kuptim dyshimi, por meqë e ka punëtore do të thotë se edhe po ta shohësh bashkë me të, kjo nuk të jep arsye për dyshim.*

*Gjithsesi, secila grua dyshon te burri i vet, e jo vetëm ti.*

*Por, kjo nuk të jep të drejtën për ta deklaruar një lidhje të mundshme...*

*Konkretisht, në pyetjen tuaj se a ke të drejtë të dyshosh, mendoj se të drejtë ke, por arsye jo...*

### Pse motra rri me burrin tim?

Jam një ish-kliente jotja që më ke ndihmuar para dhjetë vjetësh të marthohem me burrin që e kam sot. Në atë kohë më ke thënë se është i pamoralshëm dhe i tillë ka dalë! Por, e keqja është se që nga vera që shkoi disa shoqe të miat më kanë thënë se e kanë parë burrin tim me motrën time duke pirë kafe.

Kur i tregova motrës, nuk më përfilli, madje më qortoi...

"Me gjëra të tilla merresh ti, a?!", më tha.

Kjo fjali ma mbylli gojën, sepse dëshmitë s'i kisha.

Por, e keqja është se një natë,



Jam martuar para 10 vjetësh me burrin që e kam dashur vetë, por sjellja e tij ka bërë që ta urrej dhe tani kam ardhur në pikën sa jam e gatshme edhe të ndahem nga ai... Shkurt: A do të ndahem nga burri apo do ta kem këtë barrë në shpinë?

**“Ferizajasja”**

**Përgjigje:**

*Së pari, nuk je nga Ferizaj, por nga Shkupi, sepse do përgjigjen e mundohesh të mos zbulohesh! Por, kjo s’ka rëndësi... Mos nxito me veprime, sepse çdo gjë e parakohshme është e dëmshme. Zoti i madhërishtëm sjell vetë momentin kur ju do të merrni vendime. Megjithatë, parashikimi im del se do i kaloni telashet që i keni dhe prapë do të jeni në përqaftim të njëri-tjetrit.*

**Ishte keq me pas gruan të re!**

Jam 63-vjeçar. E kam gruan 17 vjet më të re se unë. Në fillim më dukej se çdo gjë ishte mirë, por s’e kisha pasur mirë! Që nga vera e kaluar, kur ishim për pushim në Velipojë, ajo po më largohet. Kur kthehet nga puna ankohet se nuk ndihet mirë dhe se ka probleme... Por, po dyshoj se nuk e ka nga lodhja, por ka hile të tjera... Ndoshta është në pyetje mosha e saj e re karshi meje? A mund të ndodh kjo?

**“I plakur para kohe”**

**Përgjigje:**

*Është mirë të mos keni paragjykime. Ka mundësi që lodhja në punë e bën të veten. Disa orë i kalon në punë, disa në shtëpi si amvisë, disa si nënë e përkushtuar ndaj fëmijëve. Dhe, kështu, pak kohë i mbetet për ty, për të mos thënë hiç, siç po ke dëshirë të të them. Pra, nuk është në pyetje dallimi në moshë, por obligimet e shumta...*

**Pse shoh ëndrra të këqija?**

Jam nga Fushë-Kosova. Ka kohë që kam probleme me lukth. Kam qenë të mjeku, më ka dhënë barëra, por problemet me lukth më shfaqen herë pas herë. Por, e keqja më e madhe është se as gjumin nuk e kam mirë. Herë-herë shoh ëndrra të këqija... Pse?

**“E Luginës...”**

**Përgjigje:**

*Parashikimi im lidhet se problemet me ëndrra të këqija i ke nga problemet me lukth. Sepse, kur ke probleme me lukth ke edhe ëndrra të këqija. E, kur s’ke probleme me lukth s’ke as ëndrra të këqija. Kështu, pra, për t’u ikur ëndrrave të këqija mos ha ushqime të rënda sidomos pas orës 19 të mbrëmjes, në mënyrë që ushqimi që ke marrë më parë të ketë mundësi të tretet para gjumit, andaj ekziston mundësia të bësh gjumë të rehatshëm...*

**A do të takohem me personin që vetëm një herë e pashë?**

Jam vajzë e pamartuar, 32-vjeçare, nga Peja, e punësuar në një ent publik shëndetësor. Verës që shkoi, në kohën kur ishin “shatcat”, kërkoi ndihmë mjekësore një burrë rreth të 50-ave, por pasi iku më mbeti në mendje dhe nuk më largohet dot. Krejt çka di është se jeton në Norvegji, e i lindur në fshatrat e Rugovës. Të lutem, a do e takoj sërish?

**“Pejania”**

**Përgjigje:**

*Vera që do të vjen do e sjellë te ti, sepse edhe ti ke mbetur në mendjen e tij, sidomos prej tetorit kur edhe i ka dhënë fund martesës shumëvjeçare me norvegjezën, të cilën në moshën e rinisë e kishte kurorëzuar për të siguruar leje qëndrimin në Norvegji. Pra, gjatë verës sërish do e takosh dhe mos prit të të afrohet, por afroju ti, sepse jeni për njëri-tjetrin. Paçi fat!*

**PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

**Kur s’e kisha në shtëpi e kërkoja, tash si ta largoj nga shtëpia?**

Jam grua 68-vjeçare, jetoj në pjesën e vjetër të Prishtinës (të lutem, mos i boto të dhënat tjera...). Tërë jetën i kam besuar burrit se nuk rrinte në shtëpi shkak i punës me biznesin e vet që shumë fliste për të si e ka me një shok. E, unë, thënë të drejtën, i besoja, edhe pse kishte të tillë që flisnin se ai shihej edhe në qytete të tjera të Kosovës. Tash, që i ka shkelur të 70-at, lëre më që nuk e përmend biznesin që e ka pasur dhe as që dihet se a e ka pasur a jo, por s’ka kush e nxjerrë nga shtëpia! Është bërë inventar i shtëpisë! Si e komenton këtë punë?

**“Pa shifër”**

**Përgjigje:**

*Gruaja dhe burri janë armiq ndërmjet veti, por të dashur. E qesin kokën me një jastëk, por janë të predispozuar ta zënë njëri-tjetrin në aut, në amoralitet! Megjithatë, në rastin tënd, nuk shoh se burri yt ka pasur raporte me ndonjë grua tjetër, por vetëm punë biznesi. Mirëpo, që nga vera e kaluar biznesi i burrit tënd ka falimentuar, andaj më s’ka ku shkon, s’ka ku rrinë. E, të vetmen strehë e ka shtëpinë, andaj edhe e ke në shtëpi edhe kah do që do sillesh... Mirëpo, meqë je mësuar të mos e kesh pranë, tash të nevrifikosë sjellja e tij nëpër shtëpi... Por, edhe me këtë gjendje do të mësohesh...*

# Bëj jetë me burrë vetëm një herë në muaj!

*Mungesa e seksit në martesë duket se është një episod që përjetohet më keq nga gratë sesa nga burrat, sidomos kur ata që e refuzojnë raportin intim janë këta të fundit.*

“Jam qe dhjetë vjet në martesë dhe, marrë në përgjithësi, të gjithë që më njohin mendojnë se kam një martesë të mirë. Mirëpo, nuk është bash kështu”, shprehet Nora, nga Klina, në pyetjen që ia bëmë se si i shkon jeta në martesë.

Nora, 32-veçje, pohon se kur ajo dhe burri i saj u takuan 15 vjet më parë, ata bënë seks çdo kohë që ata mundeshin. Por, pas

pesë vjetësh martesë, jeta e tyre seksuale filloi të tkurrej, nga shumë herë në javë, në një herë muaj!

Ajo nuk është e lumtur me këtë gjë, por burri i saj nuk është i interesuar për seks dhe nuk dëshiron të flasë sesi mund ta përmirësojnë këtë gjë që ajo e sheh si një problem të madh.

## **E PAKËNAQUR NË SEKS**

“Kam marrë një mori ankesash nga ai. Ai nuk është i disponuar, sepse puna në lokalën e tij tregtar nuk po i shkon si duhet, se gjithmonë vjen në shtëpi i lodhur, se ka dhembje lukthi a gjetiu...”, thotë ajo, e zhgënjyer me jetën e saj seksuale. Ajo dyshon se burri i saj, nëse nuk ka femër tjetër, ka humbur dëshirën për seks, por ai ka refuzuar të vizitohet te mjeku, me qëllim të tejkalimit të këtij problemi bashkëshortor.

Kur ajo flet për mungesën e seksit në raportin e tyre, burri i saj ose mbyllet ose merr pozicion mbrojtës.

Ajo i qahet atij se kështu ndihet e shëmtuar dhe se ata janë kthyer në shok-dhomë. Gratë, ndoshta, nuk mund të varen nga burrat për të qenë nxitëset seksuale në marrëdhënie, por kjo nuk do të thotë se ato janë imune në refuzimin e seksit, sidomos me normat tona tradicionale gjinore ende me ndikim.

E, burrat ndjehen të poshtëruar kur ata nuk mund të kryejnë seks, edhe nëse kjo është një pengesë psikologjike apo çështje fiziologjike.

## **Ç’THONË PSIKOLOGËT PËR KËTË DUKURI?**

Shkaqet e zakonshme fiziologjike që çojnë në rënien e dëshirës seksuale të burrave përfshijnë mosfunksionim të ereksionit, si përdorimi i medikamenteve (ilaçet kundër depresionit) dhe testosteroni i ulët ose problemet e marrëdhënieve në çift, thonë psikologët.

**Diturie Haxhaj**





# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE